



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM

**PËR ÇELJEN E GARËS PËR LËSHIMIN E 1 (NJË) LICENCE LOKALE TË SHËRBIMIT TË PROGRAMIT AUDIOVIZIV**

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv” miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 2, datë 16.01.2020, si dhe vendimit nr. 123, datë 30.11.2022 të AMA-s “Për çeljen e garës për lëshimin e 1 (një) licence lokale të shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm, në qarkun Lezhë”, në muajin janar 2023 do të organizojë procedurën e përzgjedhjes së aplikimeve për dhënien e licencave të shërbimit të programit audioviziv, si më poshtë:

1. Lëshimin e 1 (një) licence lokale të shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm, në qarkun Lezhë.

*Subjektet e interesuara për t’u pajisur me licencë shërbimi programi audioviziv janë të lutur që të depozitojnë aplikimet në Autoritetin e Mediave Audiovizive, Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 15, Tiranë, brenda datës 20 janar 2023.*

Dokumentacioni i plotë i konkurrimit të kandidaturave, që përfshin:

- Rregulloren “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv” miratuar me vendimin e AMA-s nr. 2, datë 16.01.2020, ku përfshihen kërkesat ligjore, ekonomike, teknike, programore etj;
- Pagesat për licencë,

mund të tërhiqet në zyrën e Arkivë-Protokollit, në AMA pas kryerjes së pagesës për blerje dokumentacioni në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, nga çdo subjekt që synon të marrë pjesë në konkurrim.

*Aplikimet do të hapen më datë 20 janar 2023, ora 10:00, në mjediset e AMA-s ku aplikuesit apo përfaqësuesit e autorizuar prej tyre, kanë të drejtë të jenë të pranishëm në momentin e hapjes së dosjeve të aplikimit.*